



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Data: 15.1.2025

Nr: 4

Ora: 11:30

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 14, DATË 24.10.2024 TË DEPOZITUAR
NGA TV KOPLIKU**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në seancën e datës 15.1.2024, me pjesëmarrjen e:

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Illirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKIMUES: TV Kopliku

OBJEKT: Kundërshtim i vendimit nr. 186, datë 8.10.2024 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”

BAZË LIGJORE: Nenet 21, pika 1, shkronja “b”, neni 123/1 dhe pika 3, e neni 124 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

Data: 15.1.2025 Nr: 4
Ora: 11:30



“Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 14, datë 24.10.2024 të depozituar nga TV Kopliku”

Rrethanat e çështjes:

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë në shqyrtim raportet e gjetjeve të audituesve të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023. Në përfundim të procedurës administrative, Komisioneri nëpërmjet vendimit nr. 186, datë 08.10.2024 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”, ka konstatuar shkelje në kundërshtim me Kodin Zgjedhor nga disa subjekte, një prej të cilëve edhe subjekti OSHMA “TV Kopluku” (pika 103 e dispozitivit), për të cilin ka vendosur sanksionin administrativ me gjobë në masën 100,000 lekë, në zbatim të nenit 173, pika 8 të K.Zgjedhor.
2. Kundër vendimit nr. 186, datë 08.10.2024 të KSHZ, ka paraqitur kërkesë ankimore subjekti TV Kopluku, në lidhje me sanksionin administrativ me gjobë të vendosur ndaj tij.
3. Në përputhje me rregulloren “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, u hodh shorti për caktimin e relatorit dhe u caktua anëtari z. Ledio Braho si relator i shqyrtimit të kësaj çështjeje.
4. KAS-i, pasi dëgjoi shpjegimet e palëve dhe përgjigjet e pyetjeve, mori në shqyrtim:
 - Vendimin nr. 186, datë 8.10.2024 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
 - Raportin e gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023;
 - Kërkesën Ankimore nr. 14, datë 24.10.2024 depozituar nga TV Kopluku;
 - Shkresën me Nr. 1998, datë 16.07.2024 me lëndë “Kërkesë për informacion për transmetimin e reklamave politike për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendor, të datës 14 Maj 2023” të Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së; dhe
 - Shkresën me Nr. 217 Prot., datë 22.07.2024 me lëndë “Informacion” e subjektit “TV Kopluku”

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

KAS-i konstatoi:

1. Në kuadër të vlerësimit të raporteve financiare të dorëzuara nga vetë subjektet zgjedhore, raportet e audituesve ligjorë, si dhe në raportet e monitorimit të dorëzuara nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në cilësinë e entit që monitoron pasqyrimin e fushatës, nga

verifikimet e kryera nga KQZ, ka rezultuar të ketë mospërputhje sa i përket shpenzimeve për reklama politike për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

2. Mospërputhja e evidentuar ka dalë si pasojë e rezultatit të përlllogaritjes që KQZ ka kryer nga informacioni i marrë për tarifatat zyrtare që OSHM-të kanë dorëzuar në KQZ (një prej të cilëve ka qenë edhe subjekti “TV Kopliku”), minutat e reklamave të raportuara nga AMA si dhe shpenzimet e deklaruara nga vetë subjektet zgjedhore në raportin financiar për reklama politike të shfaqura në median audio dhe vizive.
3. Sipas KQZ, në lidhje me OSHMA “TV Kopliku”, nga dokumentacioni i sipërcituar ka rezultuar se:
 - Subjekti zgjedhor Partia e Lirisë nuk ka deklaruar shpenzime për reklama politike. Nga raporti i dorëzuar nga AMA ka rezultuar se për këtë subjekt zgjedhor janë transmetuar 24.15 minuta reklama politike në televizionin “TV Kopliku”. Referuar tarifave zyrtare të depozituara ne zbatim të nenit 84 pika 5 të K.Zgjedhor nga vetë ky subjekt, reklamat politike që ka transmetuar përlllogariten në vlerën prej 12,075 lekë;
 - Subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë nuk ka deklaruar shpenzime për reklama politike. Nga raporti i dorëzuar nga AMA ka rezultuar se për këtë subjekt zgjedhor janë transmetuar 74.51 minuta reklama politike në televizionin “TV Kopliku”. Referuar tarifave zyrtare të depozituara ne zbatim të nenit 84 pika 5 të K.Zgjedhor nga vetë ky subjekt, reklamat politike që ka transmetuar përlllogariten në vlerën prej 1,415,690 lekë;
 - Subjekti zgjedhor Partia Konservatore nuk ka deklaruar shpenzime për reklama politike. Nga raporti i dorëzuar nga AMA ka rezultuar se për këtë subjekt zgjedhor janë transmetuar 58.43 minuta reklama politike në televizionin “TV Kopliku”. Referuar tarifave zyrtare të depozituara ne zbatim të nenit 84 pika 5 të K.Zgjedhor nga vetë ky subjekt, reklamat politike që ka transmetuar përlllogariten në vlerën prej 29,215 lekë; dhe
 - Subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate nuk ka deklaruar shpenzime për reklama politike. Nga raporti i dorëzuar nga AMA ka rezultuar se për këtë subjekt zgjedhor janë transmetuar 61.53 minuta reklama politike në televizionin “TV Kopliku”. Referuar tarifave zyrtare të depozituara ne zbatim të nenit 84 pika 5 të K.Zgjedhor nga vetë ky subjekt, reklamat politike që ka transmetuar përlllogariten në vlerën prej 30,765 lekë.
4. Të dhënat e sipërcituara, KQZ ja ka përcjellë ankimuesit “TV Kopliku” me shkresën me Nr. 1998, datë 16.07.2024 me lëndë “Kërkesë për informacion për transmetimin e reklamave politike për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendor, të datës 14 Maj 2023” të Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, në fund të të cilës i kërkon, sqarime brenda datës 22.07.2024 mbi këto mospërputhje.
5. Pavarësisht shkresës së KQZ, duket që edhe në përlllogaritjet e kësaj të fundit ka një mospërputhje sa i përket shifrave për vlerën e reklamave për subjektin zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë pasi 74.51 minuta me vlerën 500 lekë/minutë nuk vlejnë 1,415,690 lekë, por 37,255 lekë. **Megjithatë, thelbi i konstatimit mbetet ai që subjektet zgjedhore të sipërcituara nuk kanë deklaruar shpenzime për reklama politike për OSHMA “TV Kopliku”, ndërkohë që kjo e fundit rezulton të ketë transmetuar reklama politike për to.**

6. Në përgjigje të shkresës së sipërcituar të KQZ, OSHMA “TV Kopliku”, me shkresën me Nr. 217 Prot., datë 22.07.2024 ka cituar, ndër të tjera se *“Duke pasur parasysh vendin dhe zonën ku transmetojmë jemi munduar të mbajmë balancën e minutazhit të partive thjesht për efekt të audiencës që mos jemi të njëanshëm dhe për pjesën e monitorimit nga AMA. Përsa i përket pjesëve të pagesave nuk kanë paguar asnjëra nga këto parti, thjesht kemi mbajtur balancimin”*.
7. Referuar dispozitivit të vendimit nr. 186, datë 08.10.2024 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023” dhe më konkretisht pikës 103 të tij, rezulton se KShZ, e ka sanksionuar me dënim administrativ me gjobë ankimesin “TV Kopliku”, për shkelje të nenit 173 pika 8 të K.Zgjedhor që parashikon se *“Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, asgjësimi i dokumenteve, vonesat ose sjellja e papërshtatshme gjatë procesit të verifikimit nga KQZ-ja sipas pikës 6 të nenit 92/6, ndëshkohet me gjobë nga KQZ-ja nga 100 000 lekë deri në 3 000 000 lekë”*. Ndërkohë neni 92/6 i K.Zgjedhor rregullon auditimin e fondeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore dhe në pikën 6 të tij parashikon se *“KQZ-ja ka të drejtën të verifikojë drejtpërdrejt të ardhurat dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore për çdo parti politike të regjistruar si subjekt zgjedhor, apo kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, raportin e auditimit sipas pikës 1 të këtij neni, si dhe çdo informacion tjetër për lëndën për të cilin vihet në dijeni. KQZ-ja, për zbatim të këtij neni ka të drejtë të kërkojë të dhëna, dokumente apo informacion nga subjektet zgjedhore apo persona të tretë, të cilët duhet t’i përgjigjen kërkesës së KQZ-së brenda 15 ditëve nga marrja e saj. Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, asgjësimi i dokumenteve, vonesat ose sjellja e papërshtatshme në procesin e verifikimit të kryer nga KQZ-ja raportohet në prokurori si vepër penale, sipas nenit 248 të Kodit Penal, si dhe ndëshkohet administrativisht prej saj në përputhje me nenin 173 të këtij ligji”*.
8. Referuar dispozitave të sipërcituara, që pala e tretë (në këtë rast OSHMA “TV Kopliku”), të jetë në shkelje të nenit 92/6 pika 6 të K.Zgjedhor, e për rrjedhojë edhe në shkelje të nenit 173 pika 8 të këtij kodi, duhet që nëpërmjet formës së mosveprimit të mos bashkëpunojë ose të refuzojë për të bashkëpunuar, ose në formën e veprimit nëpërmjet asgjësimit të dokumenteve, të përgjigjes me vonesë apo të sjelljes së papërshtatshme, veprime apo mosveprime këto që duhet t’i drejtohen KQZ-së.
9. Nga provat që u depozituan gjatë shqyrtimit administrativ të kësaj kërkesë ankimore, nuk rezultoi që pala ankimese të mos ketë bashkëpunuar, të ketë refuzuar bashkëpunimin, të ketë asgjësuar dokumente, t’i jetë përgjigjur me vonesë shkresës së KQZ-së, apo të jetë sjellë në mënyrë të papërshtatshme ndaj KQZ-së. Për rrjedhojë, KAS vëren se vendimi i KShZ, për të dënuar me dënim administrativ me gjobë palën ankimese në zbatim të nenit 173 pika 8 të K.Zgjedhor, është i pambështetur në ligj dhe në prova.
10. Pavarësisht sa më sipër, referuar provave të depozituara gjatë shqyrtimit administrativ në KAS si dhe deklarimeve të vetë përfaqësuesit të OSHMA “TV Kopliku”, ka rezultuar se kjo

OSHMA ka transmetuar gjatë periudhës së fushatës zgjedhore reklama politike pa i tarifuar subjektet zgjedhore përkatëse, pavarësisht se sipas nenit 84 pika 5 të K.Zgjedhor parashikohet se *“Koha e përgjithshme e transmetimit të reklamave politike gjatë gjithë fushatës zgjedhore nga secila radio dhe televizion privat nuk mund të jetë më shumë se 90 minuta për secilën parti të regjistruar për zgjedhje. Operatorët radiotelevizivë në çdo rast zbatojnë tarifa të njëjta brenda të njëjtit segment kohor përgjatë gjithë kohës së fushatës. Operatorët radiotelevizivë detyrohen të dorëzojnë 5 ditë përpara fillimit të fushatës tarifat për çdo segment kohor pranë KQZ-së. Tarifat publikohen në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”* dhe po ashtu ka depozituar tarifa në KQZ në zbatim të këtij detyrimi ligjor.

11. Po ashtu, është për t’u theksuar, që në kuptim të K.Zgjedhor, më konkretisht nenit 92/1 pika 2 të tij që parashikon se *“Shuma që çdo person fizik ose juridik mund t’i japë një subjekti zgjedhor, përfshirë kandidatët e tij, nuk mund të jetë më e madhe se 1 milion lekë ose kundërvlera në sende ose shërbime”*, ofrimi i këtij shërbimi (i transmetimit të reklamave politike pa pagesë) pa pagesë, konsiderohet financim i fushatës zgjedhore në favor të subjekteve zgjedhore: Partia e Lirisë në vlerën prej 12,075 lekë; Partia Socialiste e Shqipërisë në vlerën prej 37,255 lekë; Partia Konservatore në vlerën prej 29,215 lekë; dhe Partia Socialdemokrate në vlerën prej 30,765 lekë nëpërmjet dhurimit të kohës televizive për reklama politike.
12. Në lidhje me këtë financim në formën e dhurimit, K.Zgjedhor në nenin 92/1 pika 3 shkronja “b” parashikon se *“3. Ndalohet dhënia e fondeve nga një person juridik apo çdo aksionar i tij nëse ndodhet në një nga kushtet e mëposhtme: ... b) ushtron veprimtari në fushën e medias”*, çka do të thotë se jemi në kushtet e një financimi/dhurimi të ndaluar, pavarësisht se nga provat nuk rezulton që subjektet zgjedhore të kenë shprehur vullnetin e tyre për pranimin e këtij dhurimi. Megjithatë transmetimi i reklamave politike nga OSHMA “TV Kopliku”, pa pagesë, klasifikohet si financim i ndaluar nga dispozita i sipërcituar. Për këtë arsye, rezulton se veprimi i OSHMA “TV Kopliku” (transmetimi i reklamave politike pa pagesë gjatë fushatës zgjedhore) i plotëson kushtet për t’u klasifikuar si shkelje administrative.
13. Ndodhur në kushtet e sipërcituara, KAS i referohet pjesës XIII (nenet 168 - 175) të K.Zgjedhor për të identifikuar sanksionin përkatës për shkeljen administrative të kryer nga OSHMA “TV Kopliku”. Referuar shkeljes administrative të subjektit ankimues qartazi nuk jemi në kushtet e nenit 169 të K.Zgjedhor pasi nuk jemi në kushtet e mosbashkëpunimit nga ana e zyrtarëve të organeve të qeverisjes vendore ose qendrore. Po ashtu, nuk jemi as në kushtet e nenit 172 të K.Zgjedhor pasi kjo dispozitë parashikon sanksionet për subjektet zgjedhore. Neni 173 i K.Zgjedhor parashikon sanksionet në lidhje me financimin e fushatës dhe më konkretisht pika 1 – 6 të kësaj dispozite parashikojnë sanksione për subjektet zgjedhore ose personat përgjegjës të financës të subjekteve zgjedhore. Pika 7 e kësaj dispozite parashikon rastin kur dhuruesi shkel përcaktimet e bëra në nenin 92/2 të K.Zgjedhor, por në rastin e OSHMA “TV Kopliku”, ky subjekt nuk është në shkelje të kësaj dispozite, por është në shkelje të nenit 92/1 pika 3 shkronja “b” të K.Zgjedhor. Po ashtu, edhe pikat 8 dhe 9, nuk sanksionojnë shkeljen administrative të OSHMA “TV Kopliku”. Më tej nenet 174 dhe 175 të K.Zgjedhor

sanksionojnë respektivisht thyerjen e heshtjes zgjedhore dhe mosrespektimin e barazisë gjinore, elementë këto që nuk janë pretenduar nga KShZ në vendimmarrjen objekt shqyrtimi administrativ. Së fundmi, për identifikimin e shkeljes administrative të subjektit ankimues, vlen të citohet neni 171 i K.Zgjedhor, i cili në pikën 1 të tij referon shkeljen e dispozitave të këtij kodi nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra sipas kodit, raste këto që nuk përputhen me shkeljen objekti shqyrtimi. Pika 3 e këtij neni sanksionon shkeljet nga sekretari i KZAZ-ve ose KQV-ve, pika 4 sanksionon shkeljet e kryera nga personat e ngarkuar me miratimin e listave të zgjedhësve dhe pika 5 sanksionon shkeljet e rregullave të tjera të parashikuara në pjesën II të K.Zgjedhor (pjesë e të cilës nuk është neni 92/1 pika 3 shkronja “b”).

14. Duke qenë se me metodën e përjashtimit asnjë prej dispozitave të sipërcituara nuk e identifikon shkeljen e OSHMA “TV Kopliku”, e vetmja dispozite që ka karakter gjeneralist dhe përfshin këtë shkelje, është neni 171 pika 2 e K.Zgjedhor që parashikon se “Shkeljet e tjera të dispozitave të këtij Kodi, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen me gjobë nga 1,000 deri në 2,500 lekë”.

15. Ndaj, për sa kemi cituar më sipër, duke qenë se OSHMA “TV Kopliku”, ka shkelur nenin 92/1 pika 3 shkronja “b” të K.Zgjedhor dhe kjo shkelje sanksionohet nga neni 171 pika 2 e këtij kodi, KAS vlerëson që ta ndryshojë dënimin administrativ me gjobë, duke mos e dënuar sipas nenit 173 pika 8 të K.Zgjedhor, por duke e dënuar sipas neni 171 pika 2 të këtij kodi, me dënim administrativ me gjobë në masën 2,500 lekë.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës ankimore nr. 14, datë 24.10.2024 të depozituar nga TV Kopliku;
2. Shfuqizimin e pikës 103 të dispozitivit të vendimit nr. 186, datë 8.10.2024 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve; dhe
3. Vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë në masën 2 500 lekë, në zbatim të nenit 171, pika 2, të Kodit Zgjedhor

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit 152 të Kodit Zgjedhor.

U shpall sot me datë 15.1.2025.

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar